



DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË  
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI MUJOR I  
SËMUNDSHMËRISË  
INFEKTIVE  
(Pasqyra 14 Sh)

MAJ, 2024

Buletini Mujoy i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga “Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike”, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin Mujoy bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS), të raportuara përmes Pasqyrës Mujoye 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Ai plotësohet në Pasqyrë në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin maj 2024 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH). Të dhënat e pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat e raportuara në SISI krahasohen nga DEKSI, dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP.

### 1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjatë muajit maj 2024 zënë 28.1 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 189.5/100.000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 4.7/100.000 banorë. NJVKSH Berat dhe Kukës mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastro-enterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa bashkive për diagnozën e saktë klinike dhe konfirmimin e saj me diagnozën

laboratorike mikrobiologjike. NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës dhe Shigelozës për muajin maj 2024 në nivel kombëtar.

*Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin maj 2024 (Incidenca raste/100.000 banorë)*


|                                        | Raste<br>maj 2024 | Incidenca maj 2024<br>(raste/100.000 banorë) |
|----------------------------------------|-------------------|----------------------------------------------|
| Tifo abdominale + Paratifo             | 1                 | 0.03                                         |
| Salmoneloza                            | 8                 | 0.3                                          |
| Shigelozë (Disenteri bacilare)         | 13                | 0.5                                          |
| Dizenteri amebike                      | 0                 | 0.0                                          |
| Toksiko-infeksione alimentare          | 135               | 4.7                                          |
| Gastro-enterite (etiologji e panjohur) | 5269              | 184.1                                        |
| Sëmundje diarreike në total            | 5426              | 189.5                                        |

2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina

2.1 Variçela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit maj 2024 janë raportuar në total 280 raste variçelë (incidenca 9.78/ 100.000 banorë ) nga të cilat, 126 raste janë të dyshuara dhe 154 të konfirmuara klinikisht, bazuar kjo në përkufizimin e rastit për sëmundjen varicelë. Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Tiranë me 126 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 1-4 vjeç me 124 raste, grafiku 1.


**Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës, maj 2024**



## 2.2 Fruthi

Gjatë muajit maj janë raportuar 3 raste si të dyshuar me fruth nga të cilat janë konfirmuar 2 raste (66.6%) nga ana laboratorike. Incidenca e sëmundjes për muajin maj është 0.07 raste/100 000 banorë.

**Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara me fruth dhe incidencë sipas muajve 2024**



Vërehet një trend i qëndrueshëm në tre muajt e fundit të vitit 2024. Të dy rastet e konfirmuara janë banorë të bashkisë Tiranë, njëri prej tyre i moshës 32 vjeç, i gjinisë femër, shtruar në spital, e vaksinuar me një dozë vaksine FRP.

Rasti tjetër i përket grup-moshës pediatrike (2 vjeç) i gjinisë femër, është ndjekur në rrugë ambulatorie dhe është vaksinuar me një dozë vaksine FRP. Të dhënat e vaksinimit janë kontrolluar në sistemin informativ elektronik të vaksinave SIV.

### 2.3 Pertusis

Gjatë muajit Maj janë raportuar 105 raste të dyshuar me Pertus. 51 (48.6%) e rasteve janë femra dhe 54 (51.4%) janë meshkuj. Mosha mediane e rasteve është 3 muaj.

Në moshën 0-1m janë (25.7%) e rasteve, në moshën 2-3m janë (22.9%) e rasteve, në moshën 4-5m janë (4.8%) dhe në moshën 6-8m janë (2.9%) e rasteve. Në grupmoshën <1 vjeç janë 59 (56.2%) e rasteve, në grupmoshën 1-4 vjeç janë (13.3%), në grupmoshën 5-9 vjeç janë (7.6%), në grupmoshën 10-14 vj janë (7.6%) e rasteve dhe ≥15 vjeç janë (15.2%) e rasteve. Nga shenjat klinike mbizotëron kollë e shpeshtë dhe me aksese mbytëse të shkurtëra dhe temperaturë.

Shumica e rasteve (34.3%) janë raportuar nga spitali pediatrik QSUT ndjekur nga Klinika “Sulcebe”, Tiranë (14.3%) dhe NJVKSH Elbasan (22.9%). Të hospitalizuar kanë qenë 62 raste (59%) e totalit. 53 nga 62 rastet e hospitalizuara ose 85.5% e të hospitalizuarve janë të moshes <1 vjeç. Vërehet që 36.2% e rasteve banojnë në Tiranë ndjekur nga Elbasani (28.6%).

21 (20%) raste kanë rezultuar pozitive për Pertus, 59 (56.2%) negative dhe 25 (23.8%) janë të dyshuar klinikisht. Mosha mediane është 8 vjeç që varion nga 0 deri në 33 vjeç. Të pavaksinuar janë 20 (19%) e rasteve nga të cilët 2 prej tyre refuzojnë vaksinimin. Për çdo rast është kryer hetimi epidemiologjik dhe evidentimi i kontakteve nga NJVKSH përkatëse.

#### Vdekje


Fëmija A.K dt. lindja 11.03.2024 (2 muajsh) nga Librazhdi dhe është hospitalizuar në Pediatri QSUT në datën 27 Maj. Mostrat respiratore i është marrë në datën 28 Maj dhe është hedhur në SISI. Kampioni është analizuar në Panel Respirator për 23 patogjene virale dhe bakteriale dhe rezultoi pozitiv në Bordetella Pertus. Fëmija bën exitus në datën 31 Maj. U njoftua NJVKSH Librazhd dhe u krye hetimi epidemiologjik. Fëmija ishte i pa vaksinuar ndaj Pertus.

### 3. Hepatitet virale

#### Hepatit viral B (HBV)

Në muajin maj janë raportuar 6 raste të konfirmuar me HBV. Incidenca e HBV në muajin maj është 0.3 raste/100 000 banorë në vend.

**Grafiku 3. Numri i rasteve të reja me HBV dhe incidenca (raste/100 000 banorë) sipas muajve**




Të gjitha rastet në muajin maj i përkasin grup-moshës adulte nga 39-72 vjeç, janë banorë nga bashkia Dibër (3), Durrës (1), Bulqizë dhe Gjirokastrë (1) dhe kanë shfaqur shenja klinike të HBV.

### Hepatiti viral C (HCV)

Në muajin maj janë raportuar 2 raste të konfirmuar me HCV. Incidenca e HCV në nivel kombëtar për muajin maj është 0.07 raste/100 000 banorë.

Rastet në muajin maj i përkasin grup-moshës adulte përkatësisht 58 dhe 72 vjeç, të gjinisë femër, banorë të bashkive Durrës (1) dhe Bulqizë (1).


**Grafiku 4. Numri i rasteve të reja me HBV dhe incidenca (raste/100 000 banorë) sipas muajve**



#### 4. Sëmundje seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS


Gjatë muajit maj 2024 janë kryer 37 ekzaminime (20 meshkuj dhe 17 femra) për HIV prej të cilave 8 raste (6 meshkuj dhe 2 femra) kanë rezultuar HIV pozitiv.

**Grafiku 5. Shpërndarja e testeve dhe rasteve të konfirmuara sipas gjinisë.**



Shpërndarja gjeografike e rasteve që kanë rezultuar HIV pozitive është: Tiranë 2 raste, Korçë 1 rast, Elbasan 2 raste dhe Lezhë 2 raste.

**Grafiku 6. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara sipas Bashkive.**



Për sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshave: 3 raste i përkasin grup-moshës 25-34 vjeç, 3 raste grup-moshës 35-44 vjeç, 1 rast i përket grup-moshës 45-54 vjeç, 1 rast i përket grup-moshës 55-64 vjeç.

Rastet e konfirmuara kanë ardhur **1 rast** nga Infektivi, **2 raste** nga laboratorë privat (INTERMEDICA), **2 raste** (vullnetare) janë referuar nga NJVKSH Korçë, **2 raste** nga NJVKSH Elbasan (njëri prej tyre në ndjekje epidemiologjike) **dhe 1 rast** është referuar si vullnetar nga NJVKSH Tiranë.

Gjatë muajit maj 2024 janë raportuar 6 raste të konfirmuar Sifiliz, 3 raste janë nga Tirana, 1 nga Korça, 1 nga Durrësi dhe 1 nga Saranda.

## 5. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit maj 2024 janë raportuar gjithsej 19 raste me tuberkuloz (TB), prej të cilave 15 raste janë pulmonar dhe 4 raste ekstrapulmonar. Rastet e raportuara me TB pulmonar janë të konfirmuara dhe me sputum pozitiv. 1 prej tyre është recidiv. Rastet pulmonare përkatësisht janë: 11 në Tiranë, 2 në Durrës, 1 në Gramsh dhe 1 në Krujë. Rastet ekstrapulmonare përkatësisht janë: 2 në Tiranë, 1 në Durrës, dhe 1 në Lezhë. Konfirmimet e tyre janë kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Pothuajse të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re dhe nga shpërndarja e rasteve, ato me TB janë të fokusuara kryesisht në Tiranë me numër më të madh.

6. Sëmundjet zoonotike

Tabela 2: Shpërndarja e zoonozave në muajin maj 2024, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikecioze)


|                    | Maj (raste 2024) | Incidenca (raste/100,000) 2024 |
|--------------------|------------------|--------------------------------|
| Antraks (Plasje)   | 0                | 0.00                           |
| Brucelozë          | 3                | 0.10                           |
| Leptospirozë       | 0                | 0.00                           |
| Rikecioza të tjera | 2                | 0.07                           |

Për muajin maj janë raportuar 2 raste Rikecioze nga NJVKSH Librazhd, dhe 3 raste Brucelozë përkatësisht: 1 nga NJVKSH Gjirokaštër, 1 nga NJVKSH Tepelenë dhe 1 nga NJVKSH Shkodër.

7. Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit


Gjatë muajit maj 2024 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 37 raste të konfirmuara me COVID-19 dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin prill është 0.59 raste /100000 banorë.

Grafiku 7. Shpërndarja e incidencës sipas grup-moshave



Grup-mosha më e prekur për këtë muaj është grup-mosha 75+ vjeç me incidencë 3.61 raste për 100000 banorë e ndjekur nga grup-mosha 65-74 vjeç me incidencë 2.44 raste për 100000 banorë.

**Grafiku 8. Shpërndarja e incidencës sipas bashkive**




Bashkitë me incidencë më të lartë janë Himarë, Delvinë, Skrapar, etj.

Gjatë muajit maj 2024 janë raportuar 5 raste të shtruara në spital dhe asnjë rast vdekjeje. Konfirmimi i rasteve është bërë në 24.3% (9 raste) në ISHP dhe 75.7% (28 raste) janë konfirmuar në laboratorët e NJVKSH-ve.

### 7.1 Grip

Gjatë muajit maj janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 10 raste të konfirmuara me grip, dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin maj është 0.35 raste /100000 banorë. Grafiku 9 tregon shpërndarjen e rasteve sipas tipit të virusëve qarkullues. Vërehet mbizotërim i gripit tipi B.

**Grafiku 9. Tipi i virusëve qarkullues**



Në muajin maj qarkullimi i gripit paraqet aktivitet sezonal normal të zakonshëm dhe të pritshëm për stinën. Raste me grip u identifikuan si nga survejanca sentinel ILI-SARI, ashtu edhe nga survejanca virologjike josentinel.

## 8. Sëmundje të tjera

### Leshmanioza Viscerale

Për muajin maj 2024 janë raportuar 2 raste të konfirmuar në laborator privat me Leshmaniozë Viscerale. Rastet janë përkatësisht nga Mati dhe Kruja.

INSTITUTI I  
SHËNDETIT  
PUBLIK  
  
DEKSI